SHPALLJE PËR VEND TË LIRA PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Bashkia e Elbasanit shpall proçedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës :

Punonjës i ndihmës ekonomike në lagje dhe njësi, Sektori i Pagesave të Ndihmës Ekonomike, PAK, dhe referimit të nevojave në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale pranë Agjencisë së Shërbimeve Sociale

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë përfunduar arsimin e lartë;
3. Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
4. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të veprua;
5. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);

2) Curriculum Vitae;

3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;

4) Çertifikatë e përbërjes familjare;

5) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;

6) Fotokopje e librezës së punës;

7) Raport mjeko-ligjor;

8) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

9) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm)

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm me postë pranë Bashkisë Elbasan deri më datë 16.11.2026.